

**VENDIM**  
**Nr.1210, datë 11.12.2009**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM  
TË KOMUNËS KUMAN TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kuman të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 29 (njëzet e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 122 (njëqind e njëzet e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i komunës Kuman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

| <i>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</i> | <i>Fusha e përdorimit të pronës</i>                                                                                                | <i>Lloji i transferimit</i> |
|---------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| <i>1-3,121</i>                                          | <i>Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.</i>                                | <i>Në përdorim</i>          |
| <i>4-14</i>                                             | <i>Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e Mbrojtjes civile.</i>                                                | <i>Në pronësi</i>           |
| <i>5-22,122</i>                                         | <i>Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore</i>                                                                      | <i>Në pronësi</i>           |
| <i>23-26</i>                                            | <i>Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.</i>                                                         | <i>Në pronësi</i>           |
| <i>27-30</i>                                            | <i>Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.</i>                                                | <i>Në pronësi</i>           |
| <i>31-40</i>                                            | <i>Varrezat publike</i>                                                                                                            | <i>Në pronësi</i>           |
| <i>42,46,48</i>                                         | <i>Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).</i>                      | <i>Në përdorim</i>          |
| <i>43,44,45,47,49,51,56,65,78,87,89,93</i>              | <i>Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)</i> | <i>Në pronësi</i>           |
| <i>94-107</i>                                           | <i>Infrastrukturë (Rrugë vendore)</i>                                                                                              | <i>Në pronësi</i>           |
| <i>108-112</i>                                          | <i>Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.</i>                                          | <i>Në pronësi</i>           |